



BULETINI MUJOR

HAPET SKEMA KOMBËTARE E INVESTIMEVE

Një mekanizëm i ri mbështetës i bujqësisë dhe zhvillimit rural me buxhetin e shtetit.

KOMITETI I 13-TË I MONITORIMIT TË IPARD

Me pjesëmarrjen e të gjitha strukturave zbatuese të programit IPARD.

TURI KOMBËTAR I TAKIMEVE ME FERMERËT

Informim mbi kriteret, dokumentat e aplikimit, afatet dhe përfitimet që ofron Skema e Investimeve.

Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2024

Vijon procesi i disbursimit të fondeve për Skemën Kombëtare në Bujqësi 2024. Deri në fund të muajit tetor janë financuar 61,121 fermerë me një fond prej 2.3 Miliard lekësh.

Në Skemën Kombëtare 2024 ofrohet mbështetje për: tufën bazë të matrikuluar (gjedhë dhe të imta), bletarinë, fermat organike, certifikimi Global Gap, farafidanë dhe inpute të tjera, bimët mjekësore - aromatike, si edhe mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.



SKEMA KOMBËTARE E INVESTIMEVE 2024




1 SERRA DIELLORE

4-15 mln lekë/ha në varësi të kulturës së prodhimit: luleshtrydhe, rrush, perime.




3 STALLA & STABILIMENTE

me kapacitet jo më pak se: 10 lopë, 100 të imta, 10 dosa ose 10 mijë shpendë, deri në 15 mln lekë.



2 RRJETAT ANTIBRESHËR

Deri në 1.5 mln lekë/ha për mbrojtjen e pemëve frutore, agrumeve dhe vreshtave.



4 MEKANIZIMI I BUJQËSISË

Për blerjen e traktorëve dhe pajisjeve për mekanizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtoriale, deri në 5 mln lekë.

5



MBËSHTETJE PËR AKUAKULTURËN DETARE

Për blerjen e rrjetave dhe për koshave për rritjen e peshkut, deri në 20 mln lekë/ subjekt.



Turi kombëtar i takimeve me fermerët

Mbi 20 takime në të gjithë Shqipërinë për prezantimin e këtij mekanizmi të ri, konceptuar dhe ideuar për të rritur, mbrojtur dhe modernizuar zinxhirin prodhues që kontribuon në bujqësi, nga serrat, mbrojtja nga breshëri, mbarështimi i kafshëve, mekanizimin dhe akuakulturën.



1.5 Miliard Lekë
Buxheti Total

500 Milion Lekë
Buxheti 2024

1 Miliard Lekë
Buxheti 2025



Komiteti i 13-të i Monitorimit të Programit IPARD

Mekanizmi që monitoron efektivitetin dhe zbatimin e programit IPARD përmblidhet e sektorit bujqësor dhe zhvillimin rural, duke ndihmuar fermerët dhe agrobizneset shqiptare me një impakt të drejtpërdrejtë në punësim, përmirësimin e jetesës në zonat rurale dhe përafrimin me standarde të BE-së.



Konferenca e 56-të e Drejtorëve të Agjencive të Pagesave

Kjo konferencë u mbajt në datat 16-18 tetor në Budapest, Hungari, me fokus në nevojën e aplikimit të risive teknologjike dhe politikave të reja për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian, si një mundësi për kontroll dhe monitorim më efektiv gjatë zbatimit të programeve për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Konferenca e radhës do të mbahet në Maj 2025, në Poloni, e cila mban presidencën e radhës të BE.